



**FORMULARI I VETË-ÇERTIFIKIMIT  
TË REZIDENCËS PËR QËLLIME TATIMORE TË MBAJTËSIT TË LLOGARISË SË RAPORTUESHME**

<b>PJESA 1 IDENTIFIKIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË TE RAPORTUESHME</b>	
<b>A</b> Emri i Personit Juridik:	
<b>B</b> Vendi i themelimit:	

<b>C</b>	<b>Adresa e ushtrimit të aktivitetit :</b>		
<b>D</b>	<b>Adresa për korespondencë (Plotësohet nëse është e ndryshme nga ajo e Seksionin C)</b>		

<b>PJESA 2</b>	<b>LLOJI I PERSONIT JURIDIK</b> <i>Ju lutemi jepni statusin e mbajtësit të llogarisë duke shënuar një nga kutitë e mëposhtme</i>
<b>1. (a) Insitucion Financiar - Entitet Investimesh</b>	
<i>i. Një entitet investimesh i vendosur në një juridiksion jo pjesëmarrës dhe menaxhohet nga një institucion tjetër financiar (Shënim: nëse shënoni këtë kuti, ju lutemi plotësoni edhe Pjesën 2 (2) më poshtë)</i>	
<i>ii. Enitet tjetër i investimeve</i>	
<b>(b) Institucion Financiar - Institucion Depozitues, Institucion i Kujdestarisë ose Shoqëri e Specifikuar Sigurimesh</b>	
<b>(c) NFE Active - një korporatë, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë ose një korporatë e cila është një entitet i lidhur i një korporatë të tillë.</b>	
<b>(d) NFE aktive - një entitet qeveritar ose një bankë qendrore</b>	
<b>(e) NFE aktive - një organizatë ndërkombëtare</b>	
<b>(f) NFE aktive - përveç (c) - (e) (për shembull një NFE fillestare ose një NFE jofitimprurëse)</b>	
<b>(g) NFE pasive (Shënim: nëse shënoni këtë kuti, ju lutemi plotësoni edhe Pjesën 2 (2) më poshtë)</b>	

Nëse keni shënuar (a) ose (b) më lart, ju lutemi nëse keni një të tillë, plotësoni Numrin e Identifikimit Ndërmjetësues Global të Mbajtësit të Llogarisë ("GIIN") të marrë për qëllime të FATCA.

--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--

--	--

--	--	--

Nëse keni shënuar (c), ju lutemi jepni emrin e tregut të krijuar të letrave me vlerë, në të cilin korporata tregtohet rregullisht: \_\_\_\_\_

Nëse jeni një entitet i lidhur i një korporate të tregtuar rregullisht, ju lutemi jepni emrin e korporatës që tregtohet rregullisht që Entiteti në (c) është një entitet i lidhur me \_\_\_\_\_



2. Nëse keni shënuar 1 (a) (i) ose 1 (g) më lart, atëherë ju lutemi:

a. Shënoni emrin e secilit person(a) kontrollues të mbajtësit të llogarisë: \*

b. Plotësoni "*Formularin e vetë-çertifikimit të rezidencës tatimore të Personit Kontrollues*" për secilin person Kontrollues. \*

*Ju lutemi shikoni përkufizimin e personit kontrollues në shtojcë*

PJESA 3		SHTETI/JURIDIKSIONI I REZIDENCËS PËR QËLLIME TATIMORE DHE NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË TATIMPAGUESIT PËRKATËS OSE NUMRI EKVIVALENT ME ATË ("TIN") (Shih Shtojcën)	
Shteti ku mbajtësi i llogarisë së raportueshme është rezident tatimor		TIN	Nëse nuk ka TIN në dispozicion shkruani arsyen përkatëse me A, B ose C sipas shpejegjimeve të mëposhtme
1			
2			
3			
4			
<p>Shenim: Nëse TIN-i nuk disponohet, jepni një nga arsyet e mëposhtme:  <b>Arsyeja A</b> - Shteti ku është rezident mbajtësi i llogarisë nuk lëshon TIN për banorët e tij  <b>Arsyeja B</b> - Mbajtësi i llogarisë nuk është në gjendje të marrë një TIN ose numër ekuivalent (<i>sqaroni pse nuk merret TIN-i në tabelën e mëposhtme</i>).  <b>Arsyeja C</b> - Nuk kërkohet TIN. (<i>Zgjidhni këtë arsye vetëm nëse sipas ligjit të vendit/juridiksionit përkatës nuk kërkohet</i>)</p>			
1			
2			
3			



#### Pjesa 4 - Deklaratat dhe Nënshkrimi \*

Unë e pranoj që të dhënat e plotësuara nga unë janë në përputhje me kushtet dhe rregullat që rregullojnë marrëdhënien e Llogarimbajtësit me ABA-n dhe ABA mund të përdorë dhe të raportojë informacionin e dhënë nga unë.

Unë e pranoj që të dhënat e plotësuara në këtë formular dhe informacioni në lidhje me mbajtësin e llogarisë dhe çfarëdo llogarie të raportueshme mund tu jepet autoriteteve tatimore të Republikës së Shqipërisë dhe të shkëmbehet me autoritetet tatimore të një vendi / juridiksioni tjetër ose të vendeve / juridiksioneve në të cilat Mbajtësi i llogarisë mund të jetë rezident për qëllime tatimore në bazë të marrëveshjeve ndërqeveritare për të shkëmbyer informacion mbi llogarinë financiare.

Unë vërtetoj se jam Llogarimbajtësi (ose jam i autorizuar të nënshkruaj për Mbajtësin e Llogarisë) për të gjithë llogarinë (të) me të cilat lidhet kjo formular.

**Unë deklaroj që të gjitha deklaratat e bëra në këtë formular janë të sakta dhe të plota.**

Unë marr përsipër të informoj bankën brenda 20 ditëve për çdo ndryshim në statusin e rezidencës tatimore të mbajtësit të llogarisë ose kur informacioni dhe të dhënat e mësipërme bëhen të pasakta ose jo të plota dhe siguroj bankën së për këtë do të plotësoj një formular të ri të vetë-çertifikimit.

Nënshkrimi\* \_\_\_\_\_ Data\* \_\_\_\_\_

**Shënim:** Nëse nuk jeni Mbajtës i Llogarisë, ju lutemi tregoni pozicionin në të cilin po firmosni formularin. Nëse nënshkruani me prokurë, ju lutemi bashkëngjitni edhe një kopje të legalizuar të autorizimit.



Shënim: Këto janë perkufizime e shpjegime për disa nga termat e përdorura për t'ju ndihmuar në plotësimin e këtij formulari. Detaje të mëtejshme mund të gjenden në Standardin e Përbashkët të Raportimit të OECD-së për Shkëmbimi automatik të informacionit për llogarinë financiare (CRS), në komentarin e CRS-së (që gjenden në portalin e OECD-së për shkëmbimin automatik të informacionit) si edhe në kuadrin ligjor e rregullator të vendit. Për ndonjë pyetje të mundshme drejtohuni tek këshilltari juaj tatimor ose në autoritetin përkatës tatimor.

**"Mbajtës i llogarisë"** është personi i listuar ose identifikuar si mbajtësi i Llogarisë Financiare nga Institucioni Financiar që mban llogarinë. Personi, i ndryshëm nga Institucioni Financiar, që mban një Llogari Financiare në përfitim të ose për llogari të një personi tjetër si agjent, kujdestar, i emëruar, nënshkruer, këshilltar investimesh ose ndërmjetës, nuk trajtohet si person që e mban llogarinë për qëllime të këtij Vendimi dhe personi tjetër trajtohet si personi që mban llogarinë. Në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrate Pensioni Vjetor, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i cili ka të drejtë të ketë akses në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin e kontratës. Nëse asnjë person nuk mund të ketë akses në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i emëruar si pronar në kontratë dhe çdo person mbi të cilin bie e drejta e pagesës sipas kushteve të kontratës. Menjëherë pas maturimit të Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratës së Pensionit Vjetor, çdo person që ka të drejtë të marrë pagesë sipas kontratës do të trajtohet si Mbajtës Llogarie.

**"NFE Aktive"** është çdo NFE (Njësi Ekonomike që nuk është një Institucion Financiar) që përmbush secilin prej kritereve të mëposhtme:

a) më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së për vitin kalendarik paraardhës ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë të ardhura Pasive dhe më pak se 50% e aktiveve të mbajtura nga NFE-ja gjatë vitit kalendarik paraardhës ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë aktive që prodhojnë ose mbahen për prodhimin e të ardhurave Pasive;

b) aksionet e NFE-së tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë ose NFE-ja është Njësi e Lidhur me një Njësi Ekonomike aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë;

c) NFE-ja është një Organ Qeveritar, një Organizatë Ndërkombëtare, një Bankë Qendrore ose një Njësi Ekonomike e zotëruar plotësisht nga një ose më shumë prej të lartpërmendurave;

ç) në thelb të gjitha aktivitetet e NFE-së konsistojnë në mbajtjen (plotësisht ose pjesërisht) të aksioneve të qarkullueshme të, ose në ofrimin e financimit dhe shërbimeve për, një ose më shumë filiale që angazhohen në tregti ose biznese të ndryshme nga biznesi i Institucionit Financiar, por Njësia Ekonomike nuk kualifikohet për këtë status nëse Njësia Ekonomike funksionon (ose pretendon se funksionon) si një fond investimi, i tillë si fond privat me kapital neto, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë, ose çdo instrument investimi qëllimi i të cilit është blerja ose financimi i shoqërive dhe më pas mbajtja e interesave në ato shoqëri si aktive kapitali për qëllime investimi;

d) NFE ende nuk po operon një biznes dhe nuk ka asnjë historik të mëparshëm operimi, por po investon kapital në aktive me synimin për të operuar një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar, me kusht që NFE-ja nuk kualifikohet për këtë përjashtim pas datës e cila është 24 muaj pas datës së organizimit fillestar të NFE-së;

dh) NFE-ja nuk ka qenë një Institucion Financiar në pesë vitet e fundit, dhe është në procesin e likuidimit të aktiveve të saj ose po riorganizohet me qëllim vijimin ose rifillimin e operacioneve në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar;

e) NFE-ja angazhohet kryesisht në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve me, ose për, Njësitë Ekonomike të Lidhura që nuk janë Institucione Financiare, dhe nuk i ofron shërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë Njësie Ekonomike që nuk është Njësi Ekonomike e Lidhur, me kusht që grupi i çdo Njësie të tillë Ekonomike të Lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar; ose

ë) NFE-ja përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- i. ajo është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës vetëm për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, artistike, kulturore, atletike ose arsimore; ose është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës dhe është një organizatë profesionale, ligë



- biznesi, dhomë tregtie, organizatë pune, organizatë bujqësore ose e hortikulturës, ligë civile ose një organizatë e cila funksionon ekskluzivisht për promovimin e mirëqenies sociale;
- ii. ajo është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat në juridiksionin e saj të rezidencës;
  - iii. ajo nuk ka aksionarë ose anëtarë të cilët kanë një interes pronësor ose përfitimi në të ardhurat ose aktivet e saj;
  - iv. ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së nuk e lejojnë shpërndarjen ose kalimin e të ardhurave apo aktiveve në përfitim të personave privatë ose një Njësie jobamirëse përveçse në pajtim me kryerjen e aktiviteteve të bamirësisë të NFE-së, ose si pagesë e një kompensimi të arsyeshëm për shërbimet e ofruara, ose si pagesë që përfaqëson vlerën e drejtë në treg të pasurisë që ka blerë NFE; dhe
  - v. ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së kërkojnë që, pas likuidimit ose shpërbërjes së NFE-së, të gjitha aktivet e saj t'i shpërndahen një Organi Qeveritar ose organizate tjetër jofitimprurëse, ose t'i rikthehen qeverisë së juridiksionit të rezidencës së NFE-së apo çdo nënndarjeje politike të saj.

**"Kontroll"** kontrolli mbi një njësi ekonomike (person juridik) në përgjithësi ushtrohet nga personi/at fizik (individ) i cili ka interes të kontrollit të pronësisë (zakonisht në bazë të një përqindje të caktuar (psh. 25%) në njësinë ekonomike. Kur asnjë person/a fizik nuk ushtron kontroll përmes interesave të pronësisë, personi (at) kontrollues i entitetit do të jetë personi (ët) fizik që ushtron kontrollin e njësisë ekonomike me mjete të tjera. Kur asnjë person fizik nuk është identifikuar se ushtron kontrollin e njësisë ekonomike përmes interesave të pronësisë, atëherë nën CRS personi i raportueshëm konsiderohet të jetë personi fizik që mban postin më të lartë drejtues.

**"Persona kontrollues"** janë personat fizikë që ushtrojnë kontroll mbi Njësinë Ekonomike. Në rastin e një trusti, ky term nënkupton krijuesin e trustit, administratorin e trustit, ruajtësin (nëse ka), përfituesin ose kategoritë e përfituesve, dhe çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin dhe në rastin e një strukture ligjore të ndryshme nga trusti, ky term nënkupton personat në pozicione të barazvlefshme ose të ngjashme. Termi "Persona Kontrollues" duhet të interpretohet në mënyrë të pajtueshme me Rekomandimet e Task Forcës për Aksionin Financiar.

**"Institucion Kujdestarie"** është një Njësi Ekonomike që mban, si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj, aktive financiare për llogari të të tjerëve. Njësia Ekonomike mban aktive financiare për llogari të të tjerëve si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj nëse të ardhurat bruto të Njësisë Ekonomike që i atribuohen mbajtjes së aktiveve financiare dhe shërbimeve financiare të lidhura me to janë të barabarta me ose i tejkalojnë 20% të të ardhurave bruto të Njësisë Ekonomike në më pak se:

- a) periudha tre vjeçare që përfundon më 31 dhjetor përpara vitit në të cilin bëhet përcaktimi; ose
- b) periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar.

**"Institucion Depozite"** është çdo Njësi Ekonomike që pranon depozita sipas mënyrës së zakonshme të një banke ose biznesi të ngjashëm.

**"Entitet"** do të thotë një person juridik ose një strukture ligjore, i tillë si korporata, organizata, partneriteti, trusti ose fondacioni.

**"Institucion Financiar"** është një Institucion Kujdestarie, një Institucion Depozite, një Njësi Ekonomike Investimesh ose një Shoqëri Sigurimesh Specifike.

**"Njësi Ekonomike"** është personi juridik ose struktura juridike si korporata, partneriteti, trusti ose fondacioni.

**Njësia Ekonomike është një "Njësi Ekonomike e Lidhur"** e një Njësie tjetër nëse:

- a) secila prej Njësive kontrollon tjetrën;
- b) të dyja njësitë ekonomike janë nën një menaxhim të përbashkët; ose
- c) të dy njësitë ekonomike janë fonde investimi sipas përcaktimit të paragrafit b) të pikës 6 të këtij neni janë nën një menaxhim të përbashkët dhe një menaxhim i tillë përmbush detyrimet e vigjilencës së duhur të fondeve të tilla të investimit. Për këtë qëllim, kontrolli përfshin pronësinë direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votave dhe vlerës në një njësi ekonomike.

**"Fond/Njësi Ekonomike Investimesh"** është çdo Njësi Ekonomike:

- a) që kryesisht drejton si biznes një ose më shumë prej veprimtarive ose operacioneve vijuese për llogari ose në emër të një klienti, të tilla si:
  - i. tregti në instrumentet e tregut të parasë (çeqe, kambiale, certifikata depozite, derivativë, etj); këmbim valutor; këmbim, normë interesi dhe instrumente indeksi; letra me vlerë të transferueshme; ose transaksione me kontratat e së ardhmes (future) për mallrat;
  - ii. menaxhim të portofoleve individuale dhe kolektive ose
  - iii. gjithashtu investon, administron ose menaxhon aktivet financiare ose paratë për llogari të personave të tjerë; ose
- b) të ardhurat bruto të së cilës i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive



financiare, nëse Njësia Ekonomike menaxhohet nga një tjetër Njësi Ekonomike që është një Institucion Depozite, Institucion Kujdestarie, Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, ose një Njësi Ekonomike Investimesh e përshkruar më lart. Një njësi ekonomike "menaxhohet" nga një njësi ekonomike tjetër nëse njësia ekonomike menaxhuese kryen, drejtpërdrejt ose përmes një ofruesi tjetër shërbimi, ndonjë prej aktiviteteve ose veprimtarive të përshkruara në paragrafin a) në emër të njësisë ekonomike të menaxhuar. Sidoqoftë, një njësi ekonomike nuk menaxhon një njësi ekonomike tjetër nëse nuk ka autoritet për të menaxhuar pasuritë e njësisë ekonomike (tërësisht ose pjesërisht). Kur një njësi ekonomike menaxhohet nga një përzierje e Institucioneve Financiare, njësive ekonomike jo-financiare ose individëve, njësia ekonomike konsiderohet se menaxhohet nga një njësi ekonomike tjetër që është një Institucion Depozitues, një Institucion Kujdestarie, një shoqëri sigurimesh ose një fond/njësi investimesh e përshkruar në paragrafin a) nëse ndonjë prej njësive menaxhuese është kjo njësi ekonomike tjetër.

**"Llogari financiare"** nënkupton një llogari të mbajtur nga një institucion financiar dhe përfshin llogaritë depozituese, llogaritë në kujdestari dhe llogari bankare të tjera.

**"Juridiksion Pjesëmarrës"** nënkupton një juridiksion që ka nënshkruar marrëveshjen shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare dhe i cili është identifikuar si i tillë në listën e publikuar për këtë qëllim.

**"Llogari e raportueshme"** është llogaria që mbahet nga një ose më shumë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është Person i Raportueshëm, me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në bazë të procedurave të vigjilencës së duhur.

**"NFE"** është çdo Njësi Ekonomike që nuk është një Institucion Financiar (NjEJIF).

**"NFE Pasive"** është çdo: (i) NFE që nuk është NFE Aktive; ose (ii) Njësi Ekonomike e përshkruar në paragrafin që nuk është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.

**"Juridiksion i raportueshëm"** një juridiksion që ka detyrimin të japë informacion financiar për llogaritë dhe të identifikohet në listën e publikuar.

**"Person i Juridiksionit të Raportueshëm"** është individ ose Njësia Ekonomike që është rezidente në një Juridiksion të Raportueshëm në bazë të legjislacionit tatimor të këtij juridiksioni, ose pasuria e trashëgimlënësit që ka qenë rezident i një Juridiksioni të Raportueshëm. Për këtë qëllim, Njësia Ekonomike e tillë si partneriteti, partneriteti me përgjegjësi të kufizuara ose strukturat ligjore të ngjashme që nuk kanë rezidencë për qëllime tatimore, do të trajtohen si rezidentë në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi ose menaxhimi aktiv.

**"Person i Raportueshëm"** është Personi i Juridiksionit të Raportueshëm i ndryshëm nga:

- a) korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë;
- b) çdo korporatë që është Njësi Ekonomike e lidhur me korporatën e përshkruar në pikën a);
- c) Organi Qeveritar;
- ç) Organizata Ndërkombëtare;
- d) Banka Qendrore; ose
- dh) Institucioni Financiar.

**"Numër identifikues i tatimpaguesit (TIN)"** nënkupton numrin identifikues të tatimpaguesit, ose ekuivalentin e tij funksional. Për qëllime tatimore, për personat e tatueshëm "TIN" do të nënkuptojë "NIPT-in" (numri i identifikimit të personit të tatueshëm), lëshuar sipas legjislacionit shqiptar. Si numër identifikimi për qëllime tatimore, për tatimpaguesin që është individ, shërben numri personal i identifikimit, i marrë në përputhje me legjislacionin shqiptar.